

Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri sh.a.

RAPORTE FINANCIARE PERIODIKE

Tremujori II-të, viti 2026

(Sipas Kërkesave të Rregullores Nr. 60, datë 29.08.2008 të Bankës së Shqipërisë)

Data e publikimit: Korrik 2026

Përmbajtja

1. Të përgjithshme	1
2. Informacion i përmbledhur për ecurinë financiare të Bankës	4
3. Bilanci	5
3.1 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	6
3.1.1 Të ardhura neto nga interesat	7
3.1.2 Të ardhura neto nga veprimet financiare	7
3.1.3 Fitimi neto nga komisionet	7
3.2 Tregues të rentabilitetit të bankës	8
3.3 Aktivët dhe pasivët sipas maturimit të mbetur	9
4. Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë	11
5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	13
5.1 Rreziku i kredisë	13
5.2 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit	14
6. Informacion për ekspozimin ndaj rreziqeve	16
7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë	16
7.1 Rreziku i kredisë	16
7.2 Klasifikimi i portofolit të kredisë	18
7.3 Klasifikimi i portofolit të kredisë sipas industrisë	22
7.4 Fondet Rezervë të Krijuara nga Banka	24
8. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë sipas metodës standarde	25
9. Teknikat e zbutjes së rrezikut	26
10. Rreziku i kredisë së kundërpartisë	27
11. Titullzimi	27
12. Rreziku i tregut	28
13. Rreziku operacional	29
14. Ekspozimet në instrumenta të kapitalit: informacion mbi pozicionet e përfshira në librin e bankës	29
15. Rreziku i normës së interesit	29
16. Rreziku i likuiditetit	30
17. Depozita ekuivalente e kapitalit të degës së bankës të huaj	30
18. Matja dhe kontrolli i kufijve të rrezikut të degës së bankës të huaj	30
19. Politika e Shpërblimit	31
20. Format dhe elementët e shpërblimit për Këshillin Drejtues dhe drejtuesit ekzekutivë	31
21. Politika të rëndësishme kontabël	31

1. Të përgjithshme

Banka e Parë e Investimeve - Shqipëri (Banka) është themeluar në Republikën e Shqipërisë si shoqëri anonime më 1 Gusht 2005 dhe i ka zyrat e saj qendrore në Tiranë në adresën Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2.

Banka e Parë e Investimeve është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në datën 19 Prill 2006 me Nr. Serial SN-017289-03-08 (NIPT: K72014801J) dhe është e licensuar nga Banka e Shqipërisë (BSh) më 6 Korrik 2007, në bazë të së cilës asaj i lejohet të kryejë të gjithë veprimet bankare të lejuara nga legjislacioni shqiptar. Banka është kryesisht e përfshirë në shërbimet bankare të korporatave dhe atyre retail si dhe është licensuar nga BSh për të vepruar si depozitar i Sipërmarrjeve Kolektive me vendimin Nr.175 datë 13.12.2011. Banka është një filial i Bankës së Parë të Investimeve A.D. (më pas "Mëma"), një entitet i krijuar në Bullgari si institucion financiar e cila zotëron 100% të aksioneve të Bankës. (numri i kontributeve: 1,413,000; vlera nominale 1,073.26 Lekë). Më parë Banka operonte si një degë e huaj e Mëmës në Shqipëri që nga Shkurti i vitit 1999.

Zyrat qendrore të Bankës së Parë të Investimeve – Shqipëri sh.a. ndodhen në Tiranë. Rrjeti përfshin 1 degë dhe 15 agjensi. Një degë dhe katër agjensi ndodhen në Tiranë (Tirana 1-Kompleksi Delijorgji, Twin Towers, Tirana 2-Astiri, Tirana 3-ish stacioni i trenit, Kamëz) dhe agjensitë e tjera ndodhen në: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Kavajë, Korçë, Lezhë, Lushnjë, Sarandë, Shkodër dhe Vlorë.

a) Informacion lidhur me bankën-mëmë

Banka e Parë e Investimeve A.D. është kompani aksionere e regjistruar nga Gjykata e Rrethit Sofie më 8 Tetor 1993. Banka e Parë e Investimeve A.D. zotëron gjithashtu shumicën e aksioneve në institucionet të tjera financiare si: First Investment Finance B.V., Balkan Financial Services, Diners Club Bulgaria, FI Health Insurance AD, Creative Investment EOOD etj. Në 28 prill 2026 Fitch Ratings e klasifikoi bankën mëmë me B. Struktura e aksionerëve të mëmës më 30 qershor 2026 është si më poshtë:

Aksionerët	% e kapitalit aksioner
Z. Ivailo Dimitrov Mutaftchiev	31.36
Z. Tzeko Todorov Minev	31.36
Banka Bullgare për Zhvillim AD	18.35
Valea Foundation	7.87
Aksionerë të tjerë (aksionerë të cilët kanë aksione të cilat tregtohen në Tregun e Aksioneve në Bullgari-Sofie)	11.06
Totali	100.00


b) Tregues të rentabilitetit të bankës mëmë:

Treguesit e rentabilitetit	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
1) Kapitalin Rregullator (<i>fondet e veta</i>) (në mijë Lekë)	101,472,077	94,206,276
2) Raportin e Mjaftueshmërisë së Kapitalit (%)	21.19	21.04
3) Raporti kredisë me probleme ndaj totalit të kredisë (%)	7.96	12.59
4) Kthyeshmëria nga aktivet (ROA) (%)	1.08	0.97
5) Kthyeshmëria nga kapitali aksionar (ROE) (%)	10.33	9.13
6) Raporti i mbulimit me likuiditet (LCR) (%)	318.84	267.56

c) Informacion i përgjithshëm mbi degët e bankave të huaja.

Jo e zbatueshme. (N/A)

d) Informacion mbi strukturën e organizimit, të administrimit dhe të funksionimit të bankës.



e) Informacion mbi aktivitetet e bankës

Banka e Parë e Investimeve, Albania sh.a. në përputhje me licencën e lëshuar nga Banka e Shqipërisë si dhe me kriteret e përcaktuara në ligjin për bankat, mund të ushtrojë aktivitetet e mëposhtme financiare:

- a) Të gjitha format e kredidhënies, duke përfshirë edhe kredinë konsumatore dhe hipotekare
- b) Qiranë Financiare
- c) Të gjitha shërbimet e pagesave dhe të transferimit të parave
- d) Ofrimin e garancive dhe marrjen e angazhimeve
- e) Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetëorganizuar (OTC) ose ndryshe, si më poshtë:
 - i. Instrumente të tregut të parasë (çeqe, dëftesa, çertifikata depozitash etj..)
 - ii. Këmbim valutor
 - iii. Produkte derivative (instrumente derivative), duke përfshirë, midis të tjerave, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me opsione (options)
 - iv. Instrumente të këmbimeve valutore dhe instrumente për vlerësimin e normës së interesit, duke përfshirë këtu produkte të tilla si marrëveshje *swap* dhe marrëveshje që përcaktojnë vlerën e interesit në të ardhmen (forward agreements)
 - v. Letra me vlerë të transferueshme
 - vi. Instrumenta të tjerë të negociueshëm dhe aktive financiare, duke përfshirë veprimet me arin
 - vii. Pjesëmarrjen në emetimin e të gjitha llojeve të letrave me vlerë, duke përfshirë nënshkrimin dhe vendosjen si agjent (si publik, ashtu edhe privat) dhe kryerjen e shërbimeve lidhur me këto emetime
- f) Ofrimin e shërbimit të klasave të sigurimit
- g) Faktoring-un dhe financimin e transaksioneve tregtare
- h) Ndërmjetësimin për transaksionet monetare të mëposhtme:
 - i. Administrimin e aktiveve të tilla si administrimi i parave dhe i portofolit, administrimi i fondeve, marrja në kujdestari, shërbimet depozituese dhe të besimit
 - ii. Shërbimin për kompensimin dhe shlyerjen e pagesave të aktiveve financiare, duke përfshirë letrat me vlerë, produktet derivative dhe instrumente të tjera të negociueshme
 - iii. Sigurimin dhe transferimin e informacionit financiar si dhe përpunimin e të dhënave financiare e të programeve që kanë lidhje me të nga furnizuesit e shërbimeve të tjera financiare
- i) Shërbimet këshilluese, ndërmjetësuese dhe shërbime të tjera ndihmëse për të gjitha veprimtaritë e listuara në pikat më sipër, duke përfshirë referencën e kredisë dhe të analizës, kërkimin dhe këshillimin në lidhje me investimet dhe portofolin si dhe këshillimin mbi blerjet e mbi strategjinë dhe ristrukturimin e shoqërive; kujdestar i letrave me vlerë të qeverisë
- j) Emetimin dhe administrimin e instrumentave të pagesës (të tilla si kartat e kreditit dhe të debitit, çequet e udhëtarit dhe çequet bankare, kartat e pagesës dhe pagesat me celular) përfshirë emetimin e parasë elektronike

f) Informacion mbi filialet e bankave dhe sipërmarrje

Jo e zbatueshme. (N/A)

g) Informacion mbi sipërmarrjet mëmë dhe sipërmarrjet aksioneve kryesore

Jo e zbatueshme. (N/A)

h) Informacion i degës së bankës së huaj lidhur me bankën-mëmë

Jo e zbatueshme. (N/A)

2. Informacion i përmbledhur për ecurinë financiare të Bankës

Në 30 qershor 2026 aktivet e bankës arritën në 75,104,377 mijë Lekë. Struktura e aktiveve të bankës mbeti relativisht e pandryshuar duke reflektuar kushtet e tregut dhe strategjinë e Bankës për të mbajtur një ekuilibër të përshtatshëm midis rrezikut, kapitalit dhe përfitueshmërisë. Huadhënia për klientët, si aktiviteti parësor i Bankës, është edhe zëri kryesor i aktiveve me 55% të totalit, i ndjekur nga investimet në instrumentat financiarë me 31%, arka dhe balancat në Bankën e Shqipërisë me 10% dhe vendosjet në bankat rezidente dhe jorezidente me 3%. Zërat e tjerë të aktivitetit zënë vetëm 1% të totalit të aktiveve dhe janë kryesisht aktive afatgjata të qëndrueshme.

Portofoli i huave bruto për klientët në fund të qershorit ishte në shumën 42,247,661 mijë Lekë. Portofoli përbëhet 53% nga kredi të dhëna ndaj sektorit të biznesit dhe 47% kredi të dhëna për individët, ndërsa sipas monedhës 55% e portofolit të huave janë në valutë dhe 45% në monedhën vendase, në të njëjtën linjë me depozitat e klientëve.

Banka e financon aktivitetin e saj nëpërmjet kapitalit të vet, dhe detyrimeve ndaj të tretëve që përbëjnë edhe pasivët e bankës. Burimi kryesor i financimit janë detyrimet ku përfshihen depozitat e klientëve që përbëjnë rreth 78% të financimit total të Bankës, ndjekur nga huamarrje nga bankat dhe institucione të tjera financiare me 7% dhe instrumenta të tjera borxhi siç janë dhe obligacionet e emetuara nga Banka me 2%. Burimi kryesor i financimit, depozitave e klientëve arritën në 60,074,928 mijë Lekë në fund të periudhës duke ruajtur strukturën e tyre me peshën kryesore llogaritë e individëve, me rreth 85% të totalit të llogarive të klientëve. Sa i përket ndarjes sipas monedhës 55% e depozitave të klientëve janë në valutë dhe 45% në monedhën vendase.

Kapitali aksionar i Bankës përfshin kapitalin e paguar, rezervat, fitimet e mbartura dhe fitimin e vitit ushtrimor. Kapitali i paguar është në vlerën ekuivalente historike të 1,516,517 mijë Lekë. Fibank Albania prej vitesh e mbështet ritmin e rritjes së saj pa pasur nevojë për shtim të kapitalit të paguar që prej vitit 2011. Përsa i përket rezervës ligjore dhe rezervave të tjera ato janë krijuar dhe mbahen në nivelin e përcaktuar nga legjislacioni përkatës i Bankës së Shqipërisë dhe ai për aktivitetin tregtar.

Fitimi i Bankës për gjysmën e parë të vitit është 508,914 mijë Lekë. Kontributin kryesor në fitim e kanë dhënë të ardhurat neto nga interesat që arritën 1,160,053 mijë Lekë. Rreth 71% e të ardhurave nga interesat përbëhen nga të ardhura nga interesat e huave ndjekur nga të ardhurat nga interesat e letrave me vlerë që shënojnë 27% të totalit të të ardhurave, kjo në të njëjtën linjë me përbërjen e zërave të aktivitetit. Të ardhura të tjera të rëndësishme janë të ardhurat nga komisionet të gjeneruara jo vetëm nga aktiviteti huadhënës por edhe nga shërbimet e tjera bankare si shërbimet e pagesave, veprimeve me kartat, POS-et, ATM-të etj. Këto të ardhura patën gjithashtu një ecuri shumë pozitive dhe arritën në 242,079 mijë Lekë në fund të qershorit.

Në 30 qershor 2026, kapitali në total ishte 7,692,408 mijë Lekë ndërsa kapitali rregullator 7,944,789 mijë Lekë. Për rrjedhojë të gjithë treguesit e kapitalit qëndrojnë në nivele të kënaqshme, mbi kërkesat rregullatore. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (RMK) në 30 qershor 2026 ishte 21.3%. Kërkesat makroprudenciale për kapital më 30 qershor përmbusheshin në nivelin 309.1% ndërkohë treguesi i levës financiare ishte në nivelin 9.3%.

Raporti i likuiditetit në fund të qershorit ishte në nivelin 38.4% për të gjitha monedhat dhe 27.2% në monedhë të huaj duke qëndruar mbi nivelet e kërkesave rregullatore të Bankës së Shqipërisë. Raporti i mbulimit me likuiditet ishte 291.6% në të gjitha monedhat dhe 145.1% për monedhat e huaja të rëndësishme.

3. Bilanci

<i>(në mijë Lekë)</i>	Më 30 qershor 2026	Më 31 dhjetor 2025
AKTIVET		
Arka dhe Banka Qendrore	7,467,871	7,411,824
Hua dhe paradhënie neto për bankat dhe institucionet financiare	2,537,821	3,096,213
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me Bankën Qendrore	2,704,989	5,563,465
Hua dhe paradhënie neto për klientët	40,656,692	38,034,516
Letra me vlerë	20,482,355	18,633,505
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	587,066	558,198
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	244,246	207,827
Aktive të tjera	423,337	293,432
GJITHSEJ AKTIVET	75,104,377	73,798,980
PASIVET		
Banka Qendrore	360,445	144,436
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	3,838,323	4,425,119
Detyrime ndaj klientëve	58,935,810	57,748,745
Letra me vlerë dhe bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	1,318,981	1,233,112
Detyrime të tjera	1,282,442	1,051,170
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	443,283	456,012
Borxh i varur	1,232,684	1,382,238
Gjithsej Detyrimet	67,411,969	66,440,832
Kapitali i paguar	1,516,517	1,516,517
Diferenca rivlerësimit të kapitalit	(389,230)	(357,737)
Rezerva ligjore dhe të tjera	588,894	488,443
Fitimet e mbartura	5,467,314	4,839,682
Fitimi i vitit ushtrimor	508,914	871,243
Gjithsej Kapitali i aksionerëve	7,692,408	7,358,148
GJITHSEJ PASIVET	75,104,377	73,798,980

3.1 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (në mijë Lekë)	Më 30 qershor 2026	Më 30 qershor 2025
Të ardhura nga interesat	1,321,198	1,099,453
Shpenzime për interesat	(622,356)	(496,447)
Të ardhura neto nga interesat	698,842	603,006
Të ardhura neto nga veprimet financiare	471,137	383,697
Të ardhura nga komisionet	381,390	342,727
Shpenzime për komisione	(139,311)	(93,638)
Fitimi neto nga komisionet	242,079	249,089
Të ardhura / (Shpenzime) neto nga veprimtari të tjera bankare	(22,058)	(21,919)
Fitimi neto nga veprimtaria valutore	57,919	50,116
Totali i të ardhurave nga veprimtaria bankare	1,447,918	1,263,989
Shpenzime për personelin	(373,327)	(325,506)
Taksa përveç taksave mbi të ardhurat	(2,931)	(3,174)
Shpenzime për shërbime të jashtme	(303,451)	(247,607)
Shpenzime të përgjithshme të veprimtarisë	(679,709)	(576,287)
Të ardhurat e veprimtarisë përpara shpenzimeve për fonde rezervë	768,210	687,703
Shpenzime neto për amortizimin dhe zhvlerësimin e mjeteve të qëndrueshme	(55,652)	(39,054)
Shpenzime për fondet rezervë për huatë	(213,605)	(56,994)
Shpenzime për fondet rezervë të tjera	18,820	5,855
Humbjet neto dhe shpenzimet për fondin rezervë për llogaritë e dyshimta, letrat me vlerë dhe zërat jashtë bilancit	(39,971)	2,939
Humbjet neto dhe shpenzimet për fondin rezervë (Humbja) / Fitimi neto nga veprimtaritë e jashtëzakonshme	(290,409)	(87,254)
Fitimi i vitit ushtrimor para tatimit mbi të ardhurat	508,914	617,440
Tatimi mbi fitimin	-	-
Fitimi i vitit ushtrimor	508,914	617,440

3.1.1 Të ardhura neto nga interesat

<i>(në mijë Lekë)</i>	Më 30 qershor 2026	Më 30 qershor 2025
Nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	49,702	52,555
Nga veprimet me klientët	1,271,495	1,046,609
Nga letrat me vlerë të blera sipas marrëveshjeve të riblerjes	-	289
Të ardhura nga interesat	1,321,198	1,099,453
Për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(52,626)	(26,815)
Për veprimet me klientët	(532,282)	(448,865)
Për borxhin e varur	(29,691)	(19,334)
Për borxhe që përfaqësohen nga letrat me vlerë	(7,758)	(1,433)
Shpenzime për interesat	(622,356)	(496,447)
Të ardhura neto nga interesat	698,842	603,006

3.1.2 Të ardhura neto nga veprimet financiare

<i>(në mijë Lekë)</i>	Më 30 qershor 2026	Më 30 qershor 2025
Nga Bonot e Thesarit të investimit	1,233	5,943
Nga Bonot e Thesarit të vendosjes	50,508	52,760
Nga Bonot e Thesarit	51,741	58,703
Nga Obligacionet qeveritare të investimit	214,136	189,307
Nga Obligacionet qeveritare të vendosjes	205,261	135,687
Nga Obligacionet qeveritare	419,396	324,994
Të ardhura neto nga veprimet financiare	471,137	383,697

3.1.3 Fitimi neto nga komisionet

<i>(në mijë Lekë)</i>	Më 30 qershor 2026	Më 30 qershor 2025
Komisione nga veprimet e thesarit dhe ndërbankare	3	-
Nga transaksionet me klientët	99,673	98,320
Komisione për shërbimet bankare	281,319	244,076
Komisione të tjera	395	330
Të ardhura nga komisionet	381,390	342,727
Komisione për veprimet e thesarit dhe ndërbankare	(1,879)	(1,880)
Komisione nga shërbime bankare	(136,055)	(90,715)
Komisione për borxhet e varura	(1,376)	(1,043)
Shpenzime për komisione	(139,311)	(93,638)
Fitimi neto nga komisionet	242,079	249,089

3.2 Tregues të rentabilitetit të bankës

Më poshtë jepen treguesit kryesorë të rentabilitetit të kërkuara nga rregullorja nr. 60, “Për Kërkesat minimale të publikimit të informacionit nga bankat dhe degët e bankave të huaja”.

Treguesit e Rentabilitetit	Më 30 qershor 2026
• Kthyeshmëria nga aktivet mesatare (ROA) të ardhurat neto (bazë vjetore) / aktivet mesatare	1.4%
• rezultati neto i jashtëzakonshëm (bazë vjetore) / aktivet mesatare	0.08%
• shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë / të ardhurat bruto të veprimtarisë	46.9%
• të ardhurat neto nga interesi / shpenzimet e përgjithshme të veprimtarisë	102.8%
• kthyeshmëria nga kapitali aksioner mesatar (ROE) të ardhurat neto (bazë vjetore) / kapitali aksioner mesatar	13.5%
• aktive për punonjës (në mijë Lekë) totali i aktiveve/ numri i regjistruar i punonjësve	248,690
• të ardhurat neto nga interesat (bazë vjetore) / aktivet mesatare	1.9%
• marzhi neto nga interesat të ardhurat neto nga interesat (bazë vjetore) / aktive mesatare që sjellin të ardhura	2.1%
• të ardhurat nga interesat (bazë vjetore) / aktivet mesatare	3.5%
• shpenzime për interesa (bazë vjetore) / aktivet mesatare	1.7%
• të ardhurat neto nga interesat / të ardhurat bruto të veprimtarisë	48.3%
• të ardhurat neto nga veprimtaritë e tjera (bazë vjetore) / aktivet mesatare	-0.1%
• shpenzimet jo për interesa / të ardhurat bruto të veprimtarisë	9.6%
• shpenzime personeli / të ardhurat bruto të veprimtarisë	25.8%
• shpenzime për provigjone (bazë vjetore) / aktivet mesatare	0.5%

3.3 Aktivët dhe pasivët sipas maturimit të mbetur

AKTIVET (në mijë Lekë)	DITE	MUAJ				VITE		Totali
	Deri 7	7 dite – 1	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
Arka dhe Banka Qendrore	1,715,570	5,752,300	-	-	-	-	-	7,467,871
Hua dhe paradhënie neto për bankat dhe institucionet financiare	2,216,763	-	3,786	18,364	58,609	240,299	-	2,537,821
Bono thesari dhe bono të tjera të pranueshme për rifinancim me Bankën Qendrore	-	1,187,903	1,184,091	328,635	5,196	-	-	2,705,826
Hua dhe paradhënie bruto për klientët	409,496	66,768	199,773	697,226	785,400	10,038,982	29,728,957	41,926,602
Letra me vlerë	-	4,933	24,787	934,991	1,625,307	10,211,057	7,739,743	20,540,818
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	-	-	-	-	-	-	587,066	587,066
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	-	-	-	-	244,246	244,246
Aktive të tjera	732,609	-	-	-	-	-	-	732,609
Aktivët gjithsej	5,074,439	7,011,905	1,412,436	1,979,217	2,474,513	20,490,337	38,300,012	76,742,859
Angazhime financiare të dhëna klientëve (pjesë e papërdorur e linjave të kredisë)	1,145,939	-	-	-	-	-	-	1,145,939
Totali i zërave jashtë bilancit	1,145,939	-	-	-	-	-	-	1,145,939
Totali i aktivit + Totali i zërave jashtë bilancit	6,220,377	7,011,905	1,412,436	1,979,217	2,474,513	20,490,337	38,300,012	77,888,798

3.3 Aktivët dhe pasivët sipas maturimit të mbetur (vazhdim)

PASIVET (në mijë Lekë)	DITE	MUAJ				VITE		Totali
	Deri 7	7 dite – 1	1 - 3	3 – 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare	1,055,835	2,419,084	30,175	54,008	119,156	520,511	-	4,198,769
Detyrime ndaj klientëve	30,395,526	2,343,249	5,107,216	5,185,614	10,171,937	5,732,269	-	58,935,810
Letra me vlerë dhe bono thesari të shitura sipas marrëveshjes së riblerjes	714,784	376,518	227,679	-	-	-	-	1,318,981
Detyrime të tjera	1,282,442	-	-	-	-	-	-	1,282,442
Fonde rezervë për rreziqe dhe shpenzime	-	-	-	-	-	-	443,283	443,283
Borxh i varur	-	-	-	5,098	97,906	470,700	658,980	1,232,684
Detyrimet gjithsej	33,448,587	5,138,851	5,365,070	5,244,720	10,388,998	6,723,479	1,102,263	67,411,969
Kapitali i paguar	-	-	-	-	-	-	1,516,517	1,516,517
Diferenca rivlerësimit të kapitalit	-	-	-	-	-	-	(389,230)	(389,230)
Rezerva ligjore dhe të tjera	-	-	-	-	-	-	588,894	588,894
Fitimet e mbartura	-	-	-	-	-	-	5,467,314	5,467,314
Fitimi i vitit ushtrimor	-	-	-	-	-	-	508,914	508,914
Kapitali aksioner gjithsej	-	-	-	-	-	-	7,692,408	7,692,408
Pasivët gjithsej	33,448,587	5,138,851	5,365,070	5,244,720	10,388,998	6,723,479	8,794,671	75,104,377
Angazhime financiare të marra institucione të kreditit (pjesë e papërdorur e linjave të kredisë)	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i zërave jashtë bilancit	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali i pasivit + Totali i zërave jashtë bilancit	33,448,587	5,138,851	5,365,070	5,244,720	10,388,998	6,723,479	8,794,671	75,104,377

4. Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë

Kapitali rregullator

Banka e Shqipërisë vendos dhe monitoron kërkesat në lidhje me kapitalin rregullator. Në implementimin e kërkesave aktuale për kapitalin rregullator, Banka është e detyruar të mbajë në jo më pak se 12% raportin e totalit të kapitalit rregullator mbi aktivet e ponderuara me normat e rrezikut. Normat e rrezikut të përdorura për ponderimin e aktiveve përcaktohen në përputhje me kërkesat specifike të cilat kanë për qëllim të reflektojnë nivelet e ndryshme të rrezikut që mbartin aktivet dhe zërat jashtë bilancit.

Banka i llogarit kërkesat për ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke u bazuar në rregulloren e Bankës së Shqipërisë mbi mjaftueshmërinë e kapitalit. Ekspozimet merren në konsideratë duke përdorur shumat e tyre në datën e raportimit. Zërat jashtë bilancit të lidhura me angazhimet llogariten duke aplikuar kategori të ndryshme të faktorëve të konvertimit, të dizenuara për të konvertuar këto zëra në ekuivalentë të bilancit. Shumat e rezultuara ekuivalente ponderohen për rrezikun duke përdorur përqindje të ndryshme (si 0%, 20%, 35%, 50%, 75%, 85% 100%, dhe 150%) në varësi të klasave të ekspozimeve.

Kapitali rregullator i Bankës ndahet në dy kategori:

- Kapitali i nivelit të parë, i cili përfshin kapitalin e aksioneve të zakonshme, primet e aksioneve, rezervat statutorë, rezerva të tjera të përgjithshme, fitimi i akumuluar nga vitet e mëparshme dhe interesi i pakicës pas zbritjes së emrit të mirë, aktivet e qëndrueshme të patrupëzuara dhe humbjet e porealizuara nga investimet e vlefshme për shitje.
- Kapitali i nivelit të dytë, i cili përfshin borxhin e varur të kualifikuar, përkatësisht borxhin e vazhdueshëm si dhe borxhin e varur.

Kufizimet e mëposhtme aplikohen tek elementët e kapitalit bazë: Kapitali i nivelit të dytë nuk mund të jetë më shumë se 33.3% e kapitalit të nivelit të parë. Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali në mënyrë që të ruajë besueshmërinë të investuesit, kreditorët si dhe të mbështesë zhvillimin e biznesit në të ardhmen. Impakti i nivelit të kapitalit në të ardhurat e aksionerëve është i njohur dhe Banka e pranon nevojën për të mbajtur një balancë midis mundësisë për më shumë të ardhura dhe avantazheve dhe sigurisë që vjen nga një pozicion i qëndrueshëm i kapitalit.

Drejtimi i Bankës bën monitorime të përditshme të gjithë aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe mbi zhvillimet e tregjeve ndërkombëtare duke aplikuar praktikat bankare më të mira. Mbi këtë bazë Drejtimi bën analiza mbi fitimin, likuiditetin dhe kostot e financimeve dhe implementon masat e duhura për rrezikun e kredisë, tregut (norma primare e interesit) dhe likuiditetit duke ulur kështu efektet e mundshme negative nga kriza globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet sfidave të tregut duke mbajtur një pozicion kapitali dhe likuiditeti të qëndrueshëm.

Borxhi i varur

Banka ka bërë 4 emetime të obligacioneve afatgjata në euro, secila me afat maturimi 7 vite dhe me normë interesi fikse, të pagarantuar, në formë të dematerializuar, nga të cilat emetimi i parë është maturuar dhe shlyer plotësisht. Vlera nominale e çdo obligacioni (që është shuma e përdorur në llogaritjen e pagesave të bëra për çdo obligacion) është 10,000 euro për secilën nga 4 emimet ndërkohë që shuma minimale e nënshkrimit është 20,000 euro. Për këto obligacione nuk ka kufizime mbi kalimin lirisht të pronësisë së tyre dhe obligacioni mund të transferohet lehtësisht tek një investitor tjetër përpara datës së maturimit.

Shlyerje fakultative përpara afatit nga Banka bëhet me miratim paraprak nga Banka e Shqipërisë sipas nenit 38 dhe nenit 39, Kreu IV, të Rregullores “Për kapitalin rregullator të Bankës” miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.69, datë 18.12.2014, e ndryshuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr.19, datë 04.03.2015 dhe me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 2, datë 09.01.2019.

4. Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë (vazhdim)

Këto obligacione klasifikohen si borxh i varur në përputhje me kërkesat rregullatore të Bankës së Shqipërisë dhe ato:

- nuk janë të garantuara dhe nuk janë subjekt i një garancie që përmirëson prioritetin e pretendimeve nga një prej subjekteve të mëposhtme:
 - banka ose filialet e saj,
 - banka mëmë dhe filialet e tjera të saj,
 - shoqëria holding financiare mëmë ose filialet e saj,
 - shoqëria holding me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,
 - shoqëria holding financiare me aktivitet të kombinuar ose filialet e saj,
 - subjektet palë të lidhura me subjektet e përcaktuara në nënpikat më sipër
- Instrumentet ose borxhi i varur nuk janë subjekt i ndonjë marrëveshjeje që në rastin e kundërt përmirëson përparësinë respektivisht për instrumentet ose borxhin e varur.
- Obligacionet e emetuara i përcaktojnë të drejtën investitorit për të marrë në datën e maturimit 100% të vlerës nominale të investimit.

Kapitali rregullator për mbulimin e rreziqeve të kredisë

(në mijë Lekë)

Kapitali i nivelit të parë

I. Elementet përbërëse që shtohen (A):

1. Kapitali i nënshkruar (5711)	1,516,517
2. Rezervat (përveç rezervave të rivlerësimit) (5731, 5733, 5734)	588,894
3. Primet e emetimit dhe të fuzionimit (572)	-
4. Fitimet e pashpërndara (e mbartura) (577(P))	5,467,314
5. Fitimi ushtrimor i fundit të vitit (578(P))	-
6. Fitimi ushtrimor i periudhës raportuese (578(P))	-
7. Diferenca rivlerësimi kreditore (574(P))	-

Nëntotali A=(1+2+3+4+5+6+7)	7,572,725
------------------------------------	------------------

II. Elementet përbërëse që zbriten (B):

1. Kapitali i nënshkruar i papaguar (5712)	-
2. Vlera nominale e aksioneve (të pashitura, të riblera)	-
3. Humbjet e pashpërndara (të mbartura) (577(-P))	-
4. Humbja ushtrimore (578(-P))	-
5. Diferenca rivlerësimi debitoare (negative) (574 (-P))	389,230
6. Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara (531)	244,246

Nëntotali B=(1+2+3+4+5+6)	633,476
----------------------------------	----------------

Totali kapitalit bazë të nivelit të parë C=(A-B)	6,939,248
---	------------------

Kapitali shtesë

kapitalit shtesë pas zbritjes JA=0; në të kundërt JA=J-(P+Q+V)	-
kapitalit bazë CA=C+J-(P+Q+V); në të kundërt CA=C	6,939,248

Kapitali i nivelit të dytë

Instrumentat e kapitalit dhe borxhi i varur të njohur si kapital i nivelit të dytë (D)	1,005,541
--	-----------

Totali i kapitalit të nivelit të dytë	1,005,541
--	------------------

Totali i kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë : E=(C+D)	7,944,789
---	------------------

5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit

5.1 Rreziku i kredisë

Bazuar në rregulloren nr. 48, neni 10, Bankat klasifikojnë çdo ekspozim të zërave, brenda dhe jashtë bilancit, në një nga klasat e ekspozimit në vijim:

- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësive të sektorit publik
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)
- ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)
- ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme
- ekspozime (kredi) me probleme
- ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë
- ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara
- ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SIK
- zëra të tjerë
- ekspozime ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë
- ekspozime të kapitalit
- ekspozime në pozicione të krijuara nga titullzimi (securitization)

5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (vazhdim)

5.2 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit

	Zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit	(në mijë Lekë)
	KAPITALI RREGULLATOR	7,944,789
	RMK (%)	21.3%
	SHUMA TOTALE E EKSPOZIMEVE TE PONDERUARA ME RREZIK	37,345,418
	RREZIKU I KREDISË	
1.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rrezikun e kredisë, kundërpartisë, dhe rrezikun e shlyerjes së transaksioneve jo-DVP - Metoda Standarde (SA)	32,334,606
1.1	Klasat e ekspozimit sipas SA duke përjashtuar pozicionet e titullzimit	32,334,606
1.1.1	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive qendrore ose bankave qendrore	198,123
1.1.2	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj qeverive rajonale ose autoriteteve lokale	-
1.1.3	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj njësisë të sektorit publik	-
1.1.4	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj bankave shumëpalëshe të zhvillimit	-
1.1.5	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj organizatave ndërkombëtare	-
1.1.6	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj institucioneve të mbikëqyrura	503,399
1.1.7	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj shoqërive tregtare (korporatave)	8,760,647
1.1.8	Ekspozime ose ekspozime të mundshme ndaj portofoleve me pakicë (retail)	4,844,187
1.1.9	Ekspozime ose ekspozime të mundshme të siguruara me kolateral pasuri të paluajtshme	14,881,533
1.1.10	Ekspozime (kredi) me probleme	609,099
1.1.11	Ekspozime ndaj kategorive të klasifikuara me rrezik të lartë	715,747
1.1.12	Ekspozime në formën e obligacioneve të garantuara	-
1.1.13	Ekspozime në formën e titujve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive SiK	-
1.1.14	Zëra të tjerë	959,559
1.1.15	Ekspozimet ndaj institucioneve të mbikëqyrura dhe shoqërive tregtare me një vlerësim afatshkurtër të kredisë	862,310
1.1.16	Ekspozime të kapitalit	-
1.2	Pozicionet e titullzimit SA	-
1.2	nga të cilat rritullzime	-

5. Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (vazhdim)

5.2 Totali i zërave të bilancit dhe jashtë bilancit të ndara sipas klasave të ekspozimit (vazhdim)

	RREZIQET E TREGUT	<i>(në mijë Lekë)</i>
2.	Shuma e ekspozimeve të ponderuara me rrezik për rreziqet e tregut	-
2.1	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e shlyerjes	-
2.1.1	Rreziku i shlyerjes në librin e bankës	-
2.1.2	Rreziku i shlyerjes në librin e tregtueshëm	-
2.2	Shuma e ekspozimit me rrezik për rrezikun e pozicionit, kursit të këmbimit dhe mallrave (SA)	-
2.2.1	Rreziku i pozicionit të titujve të borxhit	-
2.2.2	Rreziku i pozicionit të instrumentave të kapitalit	-
2.2.3	Rreziku i kursit të këmbimit	-
2.2.4	Rreziku i investimeve në mallra	-
2.3	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun e përqendrimit në librin e tregtueshëm	-
	RREZIKU OPERACIONAL	
3.	Shuma e ekspozimit të ponderuar me rrezik për rrezikun operacional	5,010,813
3.1	Metoda e Treguesit Bazik (BIA)	5,010,813
3.2	Metoda Standarde / Standarde Alternative	-

6. Informacion për ekspozimin ndaj rreziqeve

Menaxhimi i Riskut ka përgjegjësinë të identifikojë, masë dhe monitorojë riskun e kredisë, riskun e tregut dhe riskun operacional në të gjitha operacionet bankare. Menaxhimi i Riskut monitoron ekspozimet e bankës që mbartin riskun e kredisë si kreditë, overdraftet, garancitë, letrat e kredisë, llogaritë e depozitave me bankat e tjera, investimet në letra me vlerë dhe për të gjithë produktet e tjerë ku debitorët kanë ose mund të kenë një detyrim direkt ose të mundshëm kundrejt bankës.

Këshilli Drejtues ka përgjegjësinë e përgjithshme për vendosjen dhe mbikëqyrjen e menaxhimit të riskut të bankës. Për qëllime të menaxhimit të tipeve të ndryshme të risqeve në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, në Bankën e Parë të Investimeve operojnë strukturat në vijim:

- Komiteti i Kredisë i Bankës së Parë të Investimeve Shqipëri ka autoritetin për të aprovuar kreditë sipas limiteve të aprovuar që nga dhjetor 2022. Anëtarët e Komitetit të Kredisë janë: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtori Ekzekutiv, Drejtori i Menaxhimit të Riskut, Drejtori i Biznesit dhe Drejtori i Departamentit Ligjor.
- Komiteti i Riskut Operacional është përgjegjës për implementimin e politikave, proceseve dhe procedurave për administrimin e riskut operacional për të gjithë produktet/shërbimet, aktivitetet, proceset dhe sistemet e bankës. Komiteti i Ngjarjeve të Riskut Operacional është i përbërë nga Drejtori i Përgjithshëm i Riskut, Drejtori Operacional, Drejtori i Njësive të Përputhshmërisë, Drejtori i Riskut Operacional dhe Financiar, Drejtori i Pagesave Ndërkombëtare dhe Bankave Korrespondente dhe Menaxheri i Rrjetit të Degëve.

Politikat e bankës për menaxhimin e riskut janë hartuar për të identifikuar dhe analizuar risqet me të cilat përballlet banka, për të vendosur limitet e risqeve dhe kontrollet dhe monitorimin e këtyre limiteve. Politikat e Menaxhimit të Risqeve dhe sistemet janë rishikuar në mënyrë permanente për të reflektuar ndryshimet në kushtet e tregut, produkteve dhe shërbimeve të ofruar.

7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë

7.1 Rreziku i kredisë

Banka është subjekt i rrezikut të kredisë nëpërmjet aktivitetit huadhënës dhe në ato raste kur ajo vepron si ndërmjetëse për llogari të klientëve të saj ose palëve të treta ose jep garanci. Në lidhje me këtë, rreziku i kredisë për Bankën lind nga mundësia që palë të ndryshme mund të mos përmbushin detyrimet e tyre kontraktuale. Menaxhimi i ekspozimit të rrezikut të kredisë ndaj huamarrësve bëhet nëpërmjet analizave të rregullta të aftësisë paguese të huamarrësve dhe përcaktimi i një note klasifikuese. Gjithashtu ekspozimi ndaj rrezikut të kredisë menaxhohet pjesërisht duke marrë kolaterale dhe garanci.

Ekspozimi kryesor i Bankës ndaj rrezikut të kredisë lind nga huatë dhe paradhëniet. Në këtë kontekst shuma e ekspozimit të kredisë është vlera kontabël e aktiveve në bilanc. Veç kësaj, Banka është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë për zërat jashtë bilanci nëpërmjet angazhimeve deri në nivelin e kredive dhe garancive të dhëna dhe marrëdhënieve kontraktuale të qiramarrjes, nga investimet dhe detyrimeve ndaj bankave.

Përqëndrimi i rrezikut të kredisë (brenda ose jashtë zërave të bilancit) që lind nga instrumentat financiarë ekziston për palë të tjera kur ato kanë karakteristika të njëjta ekonomike të cilat mund të bëjnë që aftësia e tyre për të përmbushur detyrimet kontraktuale të ndikohet njësoj nga ndryshime në kushtet ekonomike ose faktorë të tjerë. Përqëndrimi kryesor i rrezikut të kredisë lind nga lloje të ndryshme klientësh dhe vendndodhja e tyre në lidhje me investimet e Bankës, huatë dhe paradhëniet, detyrimet e ardhshme të angazhimeve në nivelin e kredisë dhe garancive të dhëna.

7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë (vazhdim)

7.1 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve raportohen neto nga provigjioni për humbjet specifike nga kreditë për kreditë e klasifikuara si nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura. Provigjionet e krijuara për humbje të mundshme për kreditë e klasifikuara si standarte dhe në ndjekje janë klasifikuar si provigjon statistikor në pasiv të bilancit kontabël. Politikat e kredidhënies dhe procedurat e Bankës janë në përputhje me instruksionet e Bankës së Shqipërisë. Provigjionet krijohen në zbatim të rregullores Nr. 62 të Bankës së Shqipërisë “Për Menaxhimin e Rrezikut të Kredisë” (Rregullorja e kredisë) e miratuar me vendim të Këshillit Mbikqyrës datë 14 shtator 2011. Banka i klasifikon kreditë sipas kategorive të mëposhtme duke adoptuar normat e mëposhtme të provigjionit për humbjet nga kreditë:

Lloji i kredisë	Ditë vonese për overdraftet	Ditë vonesave për huatë me afat	Norma e provigjionit për kryegjënë	Norma e provigjionit për interesin
Standarde	1-30 ditë	1-30 ditë	1%	1%
Në ndjekje	31-60 ditë	31-90 ditë	5%	5%
Nën-standarde	61-90 ditë	91-180 ditë	20%	100%
Të dyshimta	91-180 ditë	181-365 ditë	50%	100%
Të humbura	Mbi 180 ditë	Mbi 365 ditë	100%	100%

Provigjoni për humbje nga kreditë

Provigjioni është regjistruar si kundër aktiv ndaj kredive të klientëve në bilancin kontabël. Ky provigjion përfshin llogaritje të cilat mbulojnë humbjet e mundshme nga kreditë nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura.

Provigjoni për rreziqet dhe shpenzimet

Provigjioni për rrezikun statistikor për kreditë dhe garancitë është i bazuar në informacion statistikor të lidhura me humbjet nga kreditë nga kreditë standarte dhe në ndjekje.

7. Rreziku i kredisë: Informacion për portofolin e kredisë (vazhdim)

7.2 Klasifikimi i portofolit të kredisë

a. Kredi për rezidentët sipas degëve të ekonomisë

(në mijë Lekë)	Kredi e re (për tremujorin)	Teprica gjithsej në fund të tremujorit
Kredi afatshkurtër	101,464	1,618,402
